



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesues i KD-së
Prof. dr. Ismet Salihu

Nr. Prot.: 3/917
Datë: 27/12/2017

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", pasi shqyrtoi kërkesat e studentëve të doktoratës në disa njësi akademik. Në mbledhjen e mbajtur më 21. 12. 2017, mori:

V E N D I M

- I. Studentët e studimeve të doktoratës që studiojnë në UP, e të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune si personel akademik në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe që kanë përfunduar ligjëratat dhe regjistrimin e semestrave të rregullt, në përputhje me kohëzgjatjen e studimeve (4, përkatësisht 6 semestra) lirohen nga pagesa e përsëritjes së semestrave.
- II. Studentët që i takojnë kategorisë si më sipër, janë të obliguar që të paguajnë vetëm për mbrojtjen e temës së doktoratës.
- III. Pika I e këtij vendimi nuk do të vlejë për studentët të cilët nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune si personel akademik në Universitetin e Prishtinës.
- IV. Shërbimi i studentëve të doktoratës në njësit akademike të UP-së, obligohet që të zbatoj këtë vendim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit dhe vlen deri në nxjerrjen e ndonjë vendimi tjetër.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues pasi shqyrtoi kërkesën e studentëve të doktoratës në disa njësi akademike të UP-së, e konsideroi të arsyeshme që studentëve të doktoratës të cilët njëkohësisht janë edhe personel i rregullt akademik i UP-së, t'iu krijoj rrethana lehtësuese për vazhdimin e përfundimit të studimeve të PhD duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim t'i dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së,
2. Njërive akademike të UP-së,
3. Zyrës për Çështje Studenteve,
4. Komisionit të Doktoratës,
5. Zyrës për Çështje Akademike,
6. Zyrës Ligjore të UP-së .



Këshilli Drejtues i UP-së

Prof. Dr. Ismet Salihu - Kryesues